

NE PREDIKOJMË KRISHTIN

NGA
DR. MICHAEL YOUSSEF

E Drejta e Autorit © 2013 Leading The Way.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.
www.LeadingTheWay.org

Titulli:
Ne predikojmë Krishtin

Përktheu:
Jonida Kumaraku

Citimet biblike janë marrë nga Bibla (2002)

E drejta e autorit

SHOQËRIA BIBLIKE SHQIPTARE (ABS)
TIRANË

Të drejtën për botimin në shqip

Radio 7

NE PREDIKOJMË KRISHTIN

Disa vite më parë, lexova dy deklarata për shtyp nga dy denominacione kryesore, të cilat promovonin idenë se çiftet homoseksuale janë familje. Këto deklarata për shtyp arrinin deri në blasfemi duke pohuar se në kapitullin e shtatë në Ungjillit të Markut, Zoti Jezus Krisht ishte “konvertuar” nga një fanatik në tolerant për shkak të gruas pagane.

U trondita nga shpjegimi që i kishin bërë këtij pasazhi dhe menjëherë lexova vargjet që kishin cituar.

Pastaj u nis që andej dhe shkoi në krahinën e Tiros dhe të Sidonit; hyri në një shtëpi dhe donte që askush të mos e dinte, por nuk mundi të qëndrojë i fshehur. Në fakt një grua, vajza e së cilës kishte një frymë e ndyrë, duke dëgjuar për Jezusin, erdhi dhe u hodh para këmbëve të tij. Tani ajo grua ishte greke, me prejardhje sirofenikase; dhe iu lut që ta

dëbonte demonin nga e bija; por Jezusi i tha: “Lëri më parë fëmijët të ngopen, sepse nuk është mirë të merret buka e fëmijëve e t’u hidhet këlyshëve të qenve.” Por ajo u përgjigj dhe i tha: “Mirë po flet, o Zot, por edhe këlyshët nën tryezë hanë thërimet e fëmijëve!” Atëherë ai i tha: “Për këtë fjalën tënde, shko; demoni doli nga vajza jote!” Dhe ajo, kur u kthye në shtëpinë e vet, e gjeti të bijën në shtrat, dhe demoni i kishte dalë. (Marku 7:24 –30)

Ky pasazh nga Bibla shënon takimin e Zotit Jezus Krisht me gruan sirofenikase, e cila kishte ardhur tek ai për t’i kërkuar çlirimin e të bijës nga demonët. Së pari, Jezusi u ndal për t’i shpjeguar se Perëndia e kishte dërguar atë tek judenjtë, por kjo grua këmbënguli në besim dhe pati sigurinë se Krishti mund ta çlironte vajzën e saj nga fuqitë demonike që kishin nën kontroll jetën e saj.

Ishte besimi i saj i fortë që tërhoqi vëmendjen e Birit të Perëndisë. Këmbëngulja e saj ishte dëshmia e saj e fuqishme e besimit në Krishtin. Nuk ka asnjë tregues se Jezusi ishte ai që u “konvertua”. Përkundrazi jeta e kësaj gruaje ndryshoi përjetësisht sepse ajo njohu Zotin e gjallë ballë për ballë dhe besoi tek Ai.

GABIMI I BRAKTISJES SË BESIMIT

Braktisja e besimit gjithmonë mohon hyjninë e Birit të Perëndisë. Me hyjninë, nënkuptoj “bashkë ekzistencën e përjetshme” me Atin. Jezusi është i barabartë me Atin, jo siç thonë disa, se ai ka thjesht fuqi hyjnore.

Këto lajme u publikuan për të përhapur mendimin se Jezusi ishte një fanatik mendje ngushtë, një njeri që kishte nevojë të “konvertohej” nga një grua pagane në këndvështrimin e saj. Mes këtyre deklaratave të shkurtra për shtyp qëndronte fshehur përpjekja e errët për të ndikuar të tjerët që të shikojnë të vërtetën e Perëndisë brenda kontekstit të “korrektesës politike”. Dukej sikur donin të thoshin se Biri i Perëndisë ishte ai që kishte nevojë të mësonte se si të ishte tolerant ndaj atyre që ishin ndryshe nga ai.

Gjëja më absurde është se njerëzit që ulen në kishë për të dëgjuar një mesazh të tillë janë shpesh herë ata që dalin nga rruga dhe nga e vërteta e shenjtë e Perëndisë. Ata pranojnë dhe besojnë gënjeshtren e Satanit thjesht sepse pranohet nga autoriteti i kishës.

Fatkeqësisht, shumë nga drejtuesit e kishave tona vazhdojnë të promovojnë herezi të tilla.

Prandaj ne duhet të lutemi dhe t'i kërkojmë Perëndisë të ekspozojë gënjeshttrat e armikut dhe të na mësojë të qëndrojmë të patundur në besimin tonë.

Përgjegjësia jonë është që t'u shpallim të tjerëve të vërtetën e Perëndisë. Ne gjithashtu duhet të qëndrojmë të patundur në besim dhe të refuzojmë të konformojmë bindjet tona të dhëna nga Perëndia. Në vend që ti nënshtrohemi, mashtrimeve të Satanit, duhet të lutemi për urtësinë e Perëndisë dhe aftësinë për të thënë jo sa herë që tundohejmë të largohemi nga e vërteta e Perëndisë.

Veçanërisht në këto kohë të rrezikshme dhe të vështira, unë besoj se Krishti po veçon delet nga dhitë dhe grurin nga byku. Kurrë më parë nuk ka pasur një kohë të tillë.

Sidoqoftë, dëshiroj t'ju siguroj gjithashtu se këto janë kohë të gëzueshme dhe sfiduese për besimtarët. Perëndia është Sovran. Ai është në kontroll të universit dhe asgjë nuk i shpëton kujdesit të tij.

Vështirësitë që ne përballim, qoftë në nivel kombëtar apo personal në dhomëzën tonë të lutjes, na ofrojnë mundësi të pafundme për shërbesën e ungjillit dhe për të korrat në mbretërinë e Perëndisë. Gjithashtu duhet t'ju

kujtoj se ne nuk jemi brezi i parë që përballim kohë të rrezikshme si këto.

Tek Veprat e Apostujve 20:29 Pali paralajmëron drejtuesit efesianë se pas largimit të tij, “ujqër grabitqarë [ata që mësojnë braktisjen e besimit], do të hyjnë midis jush dhe nuk do ta kursejnë tufën.” .

Pali po u thotë këtyre besimtarëve të dashur që të ruhen nga sulmet më të furishme të armikut, të cilat shpesh herë vijnë tek ne si gënjeshtër të maskuara.

Shumë nga ne kanë dëgjuar të flitet për “ujqërit me rrobën e deles.” Filip Jensen i kishës anglikane të Australisë ka thënë, “Sot ujqërit kanë hequr rrobën e deles!” Me fjalë të tjera, Satani nuk ka frikë të përpiqet që të na mashtrojë. Ai i zbulon hapur rrugët e tij mashtruese përmes kishës dhe drejtuesve të saj, duke kompromentuar dhe ndotur Ungjillin e pastër të Zotit Jezus Krisht. Kjo lloj braktisjeje e besimit, ka qenë në mesin tonë që nga fillimi i historisë së krishterë.

Apostulli Pal e përmbledh dallimin mes predikimit të tij të Ungjillit dhe atij të mësuesve të rremë kur shkruan, “Sepse ne nuk predikojmë, pra, veten tonë, por Jezu Krishtin, Zotin, dhe jemi shërbëtorët tuaj për hir të Jezu Krishtit.” (2 e Korintasve 4:5).

Në ditët e para të shërbesës së tij, Pali përballi mashtrimin e judaizmit në Galati. Këta burra dëshironin t'i shtonin rituale të caktuara besimit në Krishtin si një mënyrë për të marrë shpëtimin. Qëllimi i tyre ishte të skllavëronin të krishterët me idhujtarinë e legalizmit.

Por Pali tha, “Ne predikojmë Krishtin!”

Në kohën e tij Pali u përball me gnostikët, ata që theksonin njohjen e Perëndisë më shumë se sa besimin në Krishtin, me të vërtetën e Fjalës së Perëndisë. Ndonëse këta jobesimtarë mësonin se shpëtimi vjen përmes njohurisë dhe sa më shumë njohuri të ketë një person aq më i shpëtuar do të jetë, Pali u mbajt pas të vërtetës së Fjalës së Perëndisë dhe refuzoi këtë mësim të rremë duke shpallur, “Ne predikojmë Krishtin!”

SHEKUJ TË MASHTRIMIT

Kisha e hershme përballi heretikë dhe mashtrues, të cilët në një mënyrë apo në një tjetër, ngjasojnë me heretikët e kohës sonë. Në të vërtetë, shumica e herezive të sotme janë herezi të shekullit të dytë, të tretë dhe të katërt; ato thjesht kanë një pamje tjetër. Pavarësisht nëse janë herezi të së shkuarës, të së tashmes, apo të së ardhmes, të gjitha fokusohen tek mohimi i faktit se Jezusi është Perëndia i përjetshëm në trup njerëzor.

Ja disa shembuj: Në shekullin e tretë dhe të katërt, Ariusi i Aleksandrisë, në Egjipt, këmbënguli se Jezusi ishte një njeri i mirë, i cili u birësua nga Perëndia gjatë kohës së pagëzimit të tij. Ariusi besonte se atë ditë Perëndia e birësoi Krishtin si birin e tij. Kryepeshkopi besnik i Aleksandrisë, Kryepeshkopi Athanasius, e kundërshtoi Ariusin në çdo pikë, duke këmbëngulur se “Ne predikojmë Krishtin,” i cili është Perëndi; atë Perëndi që ekzistonte përpara gjithë përjetësisë.

Në shekullin e pestë, një murg i krishterë me emrin Nestor, i cili mohoi hyjninë e Krishtit, ra në herezi dhe filloi të mësonte se Jezusi ishte një njeri i përsosur, por ishte thjesht një njeri. Të krishterët besnikë e kundërshtojnë mësimin e tij duke thënë, “Jo, ne predikojmë Krishtin, që është plotësisht Perëndi dhe plotësisht njeri, Shpëtimtarin tonë të vetëm.”

Nestori lidhet drejtpërdrejt me rritjen e Islamit, që tashmë ka 2 miliardë ndjekës që mohojnë hyjninë e Jezus Krishtit dhe përndjekin të krishterët.

Kisha mesjetare gjithashtu ra në herezinë e adhurimit të Marisë, nënës së Krishtit dhe imazheve të tjera fetare, në vend që të adhuronin birin e Perëndisë. Anëtarët e kësaj kisha i dhanë

kaq shumë pushtet klerit sa kur bëhej fjalë për prezantimin e darkës së Zotit, priftërinjtë pohonin se kishin fuqinë të ndryshonin bukën dhe verën në mishin dhe gjakun e vërtetë të Krishtit. Çfarë arrogance!

Perëndia me besnikëri ngriti njerëz si Martin Luteri, Xhon Kalvini, dhe priftërinjtë britanikë Latimerin, Ridlin dhe Kranmerin të cilët thanë, “Jo! Ne do të predikojmë Krishtin, i cili është ulur në të djathtën e fronit të Perëndisë, dhe këto janë simbole të trupit dhe gjakut të tij.”

Treqind vite më parë, njerëzve u mësuan një gënjeshtër që pohonte se Perëndia ishte i paaftë që të na shpëtojë nga vdekja e përjetshme. Në të vërtetë, këta mësues të rremë mësuan se ne duhet të shpëtojmë vetveten.

VETËM NJË MESAZH— NE PREDIKOJMË KRISHTIN

Unë besoj se ka vetëm një mesazh për kishën sot, dhe ky është që të *predikojë Krishtin*; Krishtin që na afrohet dhe na thërret që të pendohemi dhe të kthehemi tek Ai që të shpëtohemi (Mateu 3:2).

Bota jonë është bombarduar nga besimet fetare perëndimore të cilat thonë se mëkati është një iluzion, por *ne predikojmë Krishtin*, i cili është

i vetmi që mund të na shpëtojë nga vdekja në mëkatet tona.

Unitarianët thonë, “Krishti është ideali i njeriut të përsosur, dhe ne mund të bëhemi të tillë kur të arrijmë veten tonë më të lartë,” por *ne predikojmë Krishtin*, i cili është i vetmi Perëndi/Njeri i përsosur që ka jetuar ndonjëherë. Ai është me ne, por Ai është i ndarë nga ne.

Shkenca thotë se nëse dimë mjaftueshëm do të mbijetojmë, por *ne predikojmë Krishtin*, i cili është i vetmi që ka fuqinë të na shpëtojë përjetësisht.

Drejtnesit liberalë të kishës këmbëngulin në një pozitë universaliste, e cila thotë, “Perëndia është kaq i dashur, sa që askush, pavarësisht në beson në Krishtin apo jo, nuk do të ndëshkohet në ferr,” por *ne predikojmë Krishtin*, i cili një ditë do të gjykojë çdo qenie njerëzore bazuar në faktin nëse ka besuar Jezus Krishtin si Shpëtimtarin e tij personal.

Astrologjia na thotë se koha kur kemi lindur përcakton fatin tonë, por *ne predikojmë Krishtin*, i cili thotë: “Duhet të rilindësh.” Pavarësisht se kur apo ku ka lindur një person, Perëndia është i vetmi që mund t’i jap jetë të përjetshme. Ata që besojnë tek rimishërimi na thonë se në çdo jetë të re ne paguajmë gabimet e jetës së mëparshme,

por *ne predikojmë Krishtin*, i cili fal mëkatet tona dhe thotë: “Shko dhe mos mëkato më.” Pse? Sepse, “Duke qenë se është caktuar që njerëzit të vdesin vetëm një herë, dhe më pas vjen gjyqi, kështu edhe Krishti, u dha vetëm njëherë për të marrë mbi vete mëkatet e shumëve... (Hebrenjve 9:27-28).

Lëvizja e potencialit njerëzor thotë se mund të krijosh realitetin tënd, por *ne predikojmë Krishtin*, i cili thotë se jemi përgjegjës ndaj Perëndisë dhe fjalës së tij, dhe i vetmi realitet i vërtetë është realiteti biblik.

Është për t'u habitur se si kaq shumë njerëz në kishë kanë besuar gënjeshtren e Satanit dhe jo të vërtetën e Fjalës së Perëndisë.

Për shumë nuk është e turpshme që të ecin korridoreve të kishës me kafshët e tyre për t'i bekuar në altar. Disa këmbëngulin në bekimin e shkëmbinjve, gurëve dhe madje të pluhurit. Ka njerëz në kisha që përqafojnë pemët dhe komunikojnë me natyrën si perëndia e tyre. Ata na thonë se Perëndia është në çdo gjë dhe se çdo gjë është Perëndi.

Të tjerë adhurojnë, Gajën, perëndeshën e tokës dhe Sofinë, perëndeshën e urtësisë. Këto kulte besojnë se ne jemi pjesë e natyrës dhe se natyra është një pjesë e jona. Shumë nga

ata që mbështesin këtë besim thonë se jemi pjesë e mbretërisë së kafshëve dhe zogjtë janë kushërinjtë tanë. Sot kemi njerëz në kishë, që thonë se janë dakord që një foshnje të vritet në barkun e nënës. Por ata besojnë se është krim të vrasësh një specie të veçantë bufi!

Sot që të emërohesh në disa nga kishat kryesore, kualifikimi më i lartë për një kandidat është të mbështesë feminizmin. Kualifikimi i dytë është të pranojë emërimin e homoseksualëve. Por në mes të gjithë këtij devijimi nga krishterimi biblik, *ne predikojmë Krishtin*, Birin e përjetshëm të Perëndisë, i cili la lavdinë e qiejve dhe përuli veten për t'u bërë njeri.

Ne predikojmë Krishtin, që u ringjall si fitimtar nga varri, fizikisht dhe në trup, për të na siguruar për ringjalljen tonë.

Ne predikojmë Krishtin, i cili do të kthehet shpejt, mos u gaboni, do të kthehet më shpejt nga sa mendoni për të gjykuar të gjallët dhe të vdekurit!

E VËRTETA E PAKOMPROMENTUAR E PERËNDISË

Ne predikojmë Krishtin, i cili në ardhjen e parë u lind në një grazhd, por në ardhjen e tij të

dytë do të vijë të sundojë botën.

Në ardhjen e Tij të parë, ai erdhi në përlësi. Në ardhjen e dytë, do të vijë në fuqi dhe lavdi të madhe.

Në ardhjen e tij të parë, ai u var në kryq, në ardhjen e tij të dytë, do të ulet në fronin e gjykimit.

Në ardhjen e tij të parë, Krishti ishte sakrifica, Qengji i therur i Perëndisë. Në ardhjen e tij të dytë, do të vijë si Gjykatësi suprem i universit.

Në ardhjen e tij të parë, ata e tallën dhe e tërhoqën zvarrë përmes rrugëve të Jeruzalemit, por kur të kthehet sërish ai do të ndëshkojë blasfemuesit, heretikët, përndjekësit e të krishterëve dhe ata që kanë mohuar emrin e tij.

Në ardhjen e tij të parë, ai u detyrua të ulte kokën. Në ardhjen e tij të dytë, çdo gju do të përulet dhe çdo gjuhë do të rrëfejë lavdinë e Perëndisë.

Ne predikojmë Krishtin! Jo veten tonë, jo idetë tona, jo filozofinë tonë, jo atë që mendojmë se është e mirë apo e drejtë, jo atë që është korrekte politikisht. Por ne predikojmë Krishtin dhe ne jemi shërbëtorët e tij për hir dhe lavdi të Perëndisë.

Një herë më pyetën, “Jusef (Youssef), përse nuk je më tepër bamirës?” Për sa më përket mua,

nuk mund të ketë bamirësi më të madhe se sa predikimi i së vërtetës së Perëndisë, shpallja e së vërtetës së tij. Qoftë nëse e besojmë apo jo, qoftë nëse e vlerësojmë apo jo, na pëlqen apo jo, duhet të kujtojmë se jemi këtu për të kënaqur Perëndinë e gjallë. Ja pse jemi krijuar, që ta njohim atë dhe ta bëjmë të njohur.

Ne predikojmë Krishtin, Birin e pakompromentuar dhe të pandotur të Perëndisë së gjallë që ka ekzistuar përjetësisht me Atin përpara themelimit të botës.

Jezus Krishti është një gur pengese për ata që e shohin thjesht si një figurë historike apo si një mësues mes shumë të tjerëve. Ai qëndron në fokus të gjithë historisë, si fokusi i Dhjatës së Vjetër dhe asaj të Re. Ai është imazhi i Perëndisë së padukshëm. Nëse dëshironi të dini se si është Perëndia, atëherë shikoni mirë Jezusin.

Në Uashington DC, është një kopje e jashtëzakonshme e Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në pamje të parë, dokumenti duket si një ngatërresë mes rreshtave të parregullt dhe shkronjave të pazakonta. Por kur e shikon nga afër këtë dokument, papritmas vëren fytyrën e Xhorxh Uashingtonit që po të vështron. Rreshtat dhe shkronjat formojnë një pamje të ngjashme të babait të kombit të

Amerikës.

Ashtu si kujtimi i Xhorxh Uashingtonit shkëlqen në çdo gjë që Amerika bën si komb, Jezus Krishti shkëlqen shumë më tepër përmes çdo vargu të Shkrimit. Nga Zanafilla tek Zbulesa, Ai është fokusi i fjalës së Perëndisë, përgjigja për të gjitha nevojat e njerëzimit.

I PARI DHE I FUNDIT— ALFA DHE OMEGA

Që nga fillimi, nga Zanafilla tek Zbulesa, Jezus Krishti është tema qendrore e Shkrimit. Ai nuk është një produkt i kushteve politike dhe shoqërore të shekullit të parë. Ai është zbulesa e plotë e Krijuesit Perëndi, dhe jeta dhe prania e tij është në të gjitha Shkrimet.

Tek **Zanafilla**, ai është Fara e gruas.

Tek **Eksodi** ai është Qengji i Pashkës.

Tek **Levitiku**, ai është Kryepriifti.

Tek **Numrat**, ai është Shkëmbi.

Tek **Ligji i Përtërirë**, ai është Profeti.

Tek **Jozueu**, ai është Kreu i Zotit të ushtrive.

Tek **Gjyqtarët**, ai është Gjykatësi i madh dhe përfundimtar.

Tek **Ruthi**, ai është Shpenguesi qiellor.

Tek **Samueli**, ai është i Vajosuri.

Tek **Mbretërve**, ai është Mbreti mbi mbretër

dhe Zoti mbi zotër.

Tek **Kronikave**, ai është Lavdia dhe tempulli i Perëndisë.

Tek **Ezdra**, ai është Mësuesi që vjen nga Perëndia.

Tek **Nehemia**, ai është Rindërtuesi i jetëve të thyera.

Tek **Esteri**, ai është Mbrojtja e popullit të tij.

Tek **Jobi**, ai është i vetmi Ngushëllues në kohë trazirash.

Tek **Psalmet**, ai është Bariu ynë i mirë.

Tek **Predikuesit**, ai është Predikuesi i mbretërisë së Perëndisë.

Tek **Kantiku i kantikëve**, ai është Dhëndri që vjen tek nusja e tij, kisha.

Tek **Isaia**, ai është Perëndia i fuqishëm, Ati i përjetshëm, Princi i paqes.

Tek **Jeremia**, ai është Poçari që formon baltën e jetëve tona në imazhin e Perëndisë.

Tek **Vajtimet**, ai është Profeti vajtues.

Tek **Ezekieli**, ai është Rrota në mes të një rrote tjetër.

Tek **Danieli**, ai është Biri i Njeriut që po vjen mbi retë në lavdi të madhe dhe është burri i katërt në furrën me zjarr përvëlues.

Tek **Osea**, ai është Dashuria e Perëndisë për të shthururin.

Tek **Joeli**, ai është Pagëzimi në Frymën e Shenjtë.

Tek **Amosi**, ai është Autori i Gjykimit dhe mëshirës.

Tek **Abdia**, ai është Perëndia i hakmarrjes.

Tek **Jona**, ai është Shpëtimi i Zotit tonë.

Tek **Mikea**, ai është Ndërmjetësuesi i madh.

Tek **Naumi**, ai është Fortesa në ditën e fatkeqësisë.

Tek **Habakuku**, ai është Perëndia i mëshirës.

Tek **Sofonia**, ai është Themeluesi i mbretërisë së Perëndisë mbi tokë.

Tek **Hagai**, ai është dëshira e gjithë kombeve.

Tek **Zakaria**, ai është Filizi i Jehovës.

Tek **Malakia**, ai është si zjarri i shkrirësit, Biri i drejtësisë që do të ngrihet mbi botën mbarë me krahët e tij shërues.

Tek **Mateu**, ai është Mbreti Mesia.

Tek **Marku**, ai është Mrekulli bërësi.

Tek **Luka**, ai është Mjeku i madh.

Tek **Gjoni**, ai është Qengji i Perëndisë që merr mëkatën e botës.

Tek **Veprat e Apostujve**, ai është Zoti i ringjallur.

Tek **Romakëve**, ai është Shfajësimi ynë.

Tek **Korintasve**, ai është Shenjtërimi ynë.

Tek **Galatasve**, ai është Çlirimi ynë.

Tek **Efesianëve**, ai është Përsosja jonë.

Tek **Filipianëve**, ai është Gëzimi ynë.

Tek **Kolosianëve**, ai është Kreu i trupit, kishës së tij.

Tek **Thesalonikasve**, ai është Zoti që po vjen.

Tek **Timoteu**, ai është gjykatësi i gjithë njerëzimit.

Tek **Titi**, ai është Shpenguesi i të gjithë botës.

Tek **Filemoni**, ai është miku më i ngushtë se një vëlla.

Tek **Hebrenjve**, ai është Kreu dhe plotësonjësi i besimit tonë.

Tek **Jakobi**, ai është Shëruesi i gjithë kombeve.

Tek **Pjetri**, ai është Kryebariu dhe ruajtësi i shpirtrave tanë.

Tek **Gjoni**, ai është Fjala e Perëndisë.

Tek **Juda**, është ai që po vjen me mijërat e tij të shenjtë për të gjykuar tokën.

Tek **Zbulesa**, Ai është Alfa dhe Omega

... Fillimi dhe mbarimi ... Luani i fisit të Judës

... Qengji i Perëndisë, Fjala e Perëndisë...

Mbreti mbi Mbretër ... Zoti mbi zotër!

(Përdorur me leje, Integrity Music, Inc.)

A E NJEH ATË?

A e njeh Jezusin? A është ai Shpëtimtari yt? A ke një marrëdhënie personale me të? Nëse e njeh atë, a ndikon Ai çdo pjesë të jetës tënde? A është ai Zoti yt? A është ai 'shefi' me të cilin këshillohesh përpara çdo vendimi që merr?

Nëse nuk e njeh atë, ose ke humbur bashkësinë me të, mund të ripërtërish besimin dhe përkushtimin tënd ndaj tij si Shpëtimtari yt. Kur të bësh këtë lutje, ai do të bëhet i njohur dhe do të mbushë zemrën tënde me paqe dhe me një shpresë të re.

Atë, faleminderit për kurajën dhe përkushtimin që unë mund të kem përmes Birit tënd Jezus Krishtit. Unë të kërkoj të forcosh besimin tim në Zotin e ringjallur, dhe kërkoj që ti të derdhësh tek unë Frymën tënde të Shenjtë, në një mënyrë të veçantë, në mënyrë që Jezusi të jetë i pari në çdo fushë të jetës sime. Përmes Birit tënd të bekuar, më fal për mëkatën dhe mosbesimin tim. Unë të falënderoj që ti nderon këtë lutje sepse ti ke premtuar të nderosh ata që të nderojnë ty. Lutem për këtë në emrin e Jezusit dhe për hir të tij. Amen.

